L I G J
Nr.7496, datë3.7.1991

PER STATUSIN E USHTARAKUT TE FORCAVE TE ARMATOSURA TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Ne mbeshtetje te nenit 16 te ligjit nr.7491 date 29.4.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I :

Permbajtja e statusit te ushtarakut
Neni 1

Statusi i ushtarakut permban detyrat kryesore, te drejtat e kufizimet e ushtarakeve te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise, qe rrjedhin nga karakteri i vecante i detyres dhe i sherbimit ushtarak, si dhe garancite ligjore per realizimin e tyre.

Personat qe gezojne statusin e ushtarakut
Neni 2

Statusi i ushtarakut e gezojne ushtaraket e sherbimit aktiv, te detyruarit ushtarake, te thirrurit ne stervitje, si dhe persona te tjere qe me ligj barazohen me ta. Ushtaraket e gezojne kete status me fillimin e sherbimit ushtarak ose te stervitjes ushtarake dhe e humbasin ate me daljen ne lirim, me perfundimin e sherbimit ose te stervitjes ushtarake.

Detyrat kryesore te ushtarakut
Neni 3

Ushtaraku u Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise ka keto detyra kryesore:
- te jete besnik ndaj atdheut dhe interesave te kombit;
- te mbaje kurdohere lart nderin e dinjitetin e ushtarakut;
- te pergatitet ushtarakisht e te jete i gatshem dhe i disiplinuar per te bere cdo sakrifice, gjer ne dhenien e jetes per mbrojtjen e atdheut;
- te zbatoje me reptesi detyrimet qe rrjedhin nga Kushtetuta dhe aktet ligjore e nenligjore.
- te ruaje sekretin shteteror dhe pasurine ushtarake.

Ndalime dhe kufizime te te drejtave te ushtarakeve ne fushen sociale, politike, arsimore dhe kulturore
Neni 4

1. Ushtarakeve u ndalohet te marrin pjese ne parti, organizata a shoqata politike dhe sindikata.
2. Ushtarakeve u ndalohet te bejne greva, si dhe kerkesa e ankesa kolektive.
3. Ushtarakeve u ndalohet te punesohen ne kohen e tyre te lire prane personave jurdike a fizike vendas dhe te huaj, brenda ose jashte shtetit.
4. Ushtarakut, si person i kufizohet liria e zgjedhjes se vendbanimit dhe qarkullimit pa leje jashte territorit qe eshte nen juridiksionin e garnizonit ushtarak perkates.

5. Ushtaraket mund tu zgjatet koha (orari) e punes dhe e sherbimit per interesat te rendesishme te sherbimit e te detyres ushtarake.

6. Ushtaraket kane te drejten e ushtrimit e te besimit fetar, por vetem ne kohen e lire dhe pa uniforme ushtarake.

7. Ushtarakeve vetem kur u jepet leje, kane te drejte te vazhdojne studimet ne institucionet arsimore ushtarake a civile dhe te ndjekin kurse te ndryshme per kualifikimin e tyre ushtarak e per specializim brenda e jashte vendit.

Ushtareve te sherbimit te detyrueshem nuk u lejohet te vazhdojne shkollen gjate kryerjes se sherbimit ushtarak.

8. Ushtarakut i lejohet te vishet civil vetem jashte kohes se punes e te sherbimit, si dhe kur e kerkon natyra e sherbimit te tij.

9. Ushtaraket, pervec leternjoftimit, detyrohen te pajisen dhe te mbajne me vete dokumentin e identifikimit ushtarak perkates.

10. Ushtarakut te Ushtrise Popullore i ndalohet te ushtroje ne menyre te organizuar detyrat e ruajtjes se rendit, pervec rasteve kur shpallet gjendja e jashtezakonshme.

E drejta per mbajtjen dhe perdorimin e armes.

Neni 5

Ushtaraku gjate kryerjes se sherbimit dhe jashte tij ka te drejte te mbaje dhe te perdore armen vetjake sipas dispozitave ligjore.

E drejta e punes

Neni 6

Sherbimi ushtarak eshte veprimtari e vecante shoqerisht e domosdoshme per shtetin. Koha e kryerjes se shebimit ushtarak llogaritet ne vjetersine e punes.

Neni 7

Oficereve, nenoficereve dhe punonjesve te policise u ndalohet largimi nga detyra si ushtarak pa shkaqe te ligjeruara ose pa mbushur kohen e perfitimit te pensionit te pjesshe. Ne te kundert detyrohen te paguajne gjobe, masa e te ciles percaktohet me dispozita te vecanta.

Neni 8

Ushtarakeve te liruar para kohe nga sherbimi per aftesi te kufizuar shendetesore, deri ne diten e punesimit te tyre u jepet shperblimi i vecante ne masen dhe ne kohen qe percaktohet me vendim te vecante te keshillit te Ministrave.

Paga dhe shtesa te tjera mbi page

Neni 9

Per kryerjen e sherbimit, ushtarakut aktiv i jepet nje page fikse, kurse per kushte te vecanta te ketij sherbimi jepen edhe shtesa mbi page sipas funksionit organik, viteve te sherbimit, grades ushtarake, veshtiresise se punes mbi kohen normale te sherbimit te diferencuara keto per armet e sherbimit. Pagat dhe shtesat mbi page percaktohen nga Keshilli i Ministrave

Neni 10

Paga baze fillestare e oficereve, nenoficereve dhe e punonjesve te policise caktohet duke

mbajtur parasysh nivelin e pagave te punonjesve te sektorit te veshtire te
ekonomise.Perparesite ne page per ushtaraket dhe punonjesit civile ne Forcat e Armatosura caktohen me vendim te vecante te Keshillit te Ministrave.

Neni 11

Shtesa e pages per vjetersi sherbimi jepet ne masen 1 per qind ne vit mbi pagen mujore, por jo me shume se 25 per qind per gjithe kohen e sherbimit ushtarak.

Neni 12

Ushtarakeve u krijuan lehtesi ne taksa e tatime me dispozita te vecanta.

Neni 13

Struktura te vecanta te Forcave te Aermatosura trajtohen ne ushqim e materiale te tjera pa pgese, sipas normave te percaktuara nga Keshilli i Ministrave.

Neni 14

Oficeret, nenoficeret dhe punonjesit e policise nuk perfitojne paga dhe shtesa te vecanta per ditet qe ata nuk paraqiten ne detyre, ose shmangen nga puna pa arsye.

Neni 15

Pagat e shtetasve qe thirren per stevitje ushtarake ose per sherbim paguhen nga repartet ne varesi te detyres funksionale qe kryejne dhe caktohen nga Keshilli i Ministrave.

E drejta per pension

Neni 16

Oficeret dhe nenoficeret me vjetersi sherbimi ne ushtri l5 vjet per burrat dhe 12 per gra, gezojne te drejten e pensionit te pjesshem ne masen 50 per qind te pages mujore. Per cdo vit tjeter sherbimi mbi kufirin e mesiperm jepet nje shtese pensioni ne masen 2 per qine te pagese mujore. Kriteret e dhenies se pensionit percaktohen me ligjin "Per sigurimet shoqerore".

Mbrojtja shoqerore e familjes se ushtarakut.

Neni 17

Ushtarakeve ne rastet e pamundesise se punesimit te bashkeshorteve te tyre u jepet nje shtese page ne masen dhe sipas kritereve te percaktuara nga Keshilli i Ministrave.

Koha e qendrimit pa pune te bashkeshorteve ose bashkeshortit te ushtarakut, deri ne 15 vjet, ne rastet kur ne venbanimin perkates te ushtarakut nuk ekzistojne mundesi punesimi, llogaritet ne vjetersine e pegjithshme te punes per pension.

Neni 18

Familjeve te ushtareve te sherbimit aktiv (ushtare, detare, police, studente ushtarake) qe kane te ardhura per fryme nen nivelin minimal te jeteses, u jepet ndihme ne te holla ne masen e caktuar me vendim te Keshillit te Ministrave.

E drejta per pushim

Neni 19

Pushimi ditor e javor per oficerin, nenoficerin aktiv dhe punonjesin e policise si rregull njesohet me ate te punonjesit civil.

Ushtaraku qe ka qene me detyre ne ditet e pushimit javor dhe te festave zyrtare, pushimet i merr brenda muajit dhe me pelqimin e tij, ato mund te bashkohen dhe te jepen brenda 3 muajve. Kur ushtarakeve nuk u jepet pushimi javor, i festave zyrtare dhe leje vjetore per arsye gadishmerie e sherbimi, krahas pages, u jepet edhe paga e diteve per pushimin dhe lejen e pakryer.

Neni 20

Kohezgjatja e lejes se zakonshme vjetore per oficeret e sherbimit aktiv te jete deri ne 45 dite, kurse per nenoficeret dhe punonjesit e policise deri ne 30 dite, sipas percaktimit te Keshillit te Ministrave. Leja e pedagogeve ushtarake te shkollave ushtarake njesohet me ate te pedagogeve civile.

Neni 21

Leja e zakonshme per ushtaret e sherbimit aktiv eshte l5 dite per gjithe kohen e kryerjes se sherbimit.

E drejta per sigurimin e banimit

Neni 22

Oficereve, nenoficereve aktive e punonjesve te policise, si dhe familjeve te tyre, u sigurohet banese nga shteti, sipas kritereve te percaktuara me dispozita te vecanta.

E drejta per sigurimin shendetesor

Neni 23

Oficeret, nenoficeret, punonjesit e policise dhe pjestaret e familjeve te tyre qe bashkejetojne me ta, si dhe ushtaret aktive e rezerviste kur jane ne sherbimin ushtarak, perfitojne falas sherbimin mjekesor ne institucionet shteterore mjekesore ushtarake a civile.

Ushtaraku perfiton ndihme mjekesore falas edhe ne rastet kur dergohet nga institucionet mjekesore shteerore per tu kuruar ose per tu diagnostikuar jashte shtetit.

Mbrojtja e vecante ligjore

Neni 24

Gjate kryerjes se detyres dhe per shkak te saj, ushtarakut i garantohet mbrojtja e vecante ligjore.

Neni 25

Organet shteterore, organizatat e ndryshme politike e shoqerore dhe mjetet masive te informacionit, para se te shkruajne, te propogandojne ose te informojne opinionin publik per veprime qe lidhen me ushtaraket, detyrohen te respektojne kerkesat e akteve qe percaktojne sekretin shteteror.

E drejta per propozime e ankesa

Neni 26

Ushtaraku ka te drejte te beje sipas rastit propozime ose ankesa per veprime te paligjshme te organeve te pushtetit, te administrates dhe te cdo shtetasi ne organet me te larta te pushtetit, te administrates, te drejtesise e ne ato eprore ushtarake.

Pergjegjesia e ushtarakut

Neni 27

Pavareisht nga detyra e grada, ushtaraket jane te barabarte para ligjit.

Per shkeljen e akteve ligjore e nenligjore, te kerkesave te disiplines ushtarake dhe per deme materiale te shkatuara ndaj prones shteterore,shoqerore a private, ushtaraku mban perkatesisht pergjegjesi penale, administrative, materiale a civile, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe rregulloret ushtarake.

Detyra dhe pergjegjesia e organeve shteterore per sigurimin e statutusit te ushtarakut

Neni 28

Organet e pushtetit, te administrates, te drejtesise dhe komandat e njesive ushtarake, brenda kompetencave te tyre dhe ne perputhje me dispozitat ne fuqi, sigurojne realizimin e statusit te ushtarakut.

Per mosplotesimin e detyrimeve qe percaktohen ne kete ligji, personat faktore mbajne, sipas rastit, pergjegjesi disiplinore a penale, te cilat percaktohen me dispozita ligjore te vecanta.

Dispozita te fundit

Neni 29

Keshilli i Ministrave, ministrit dhe organet perkatese te nxjerrin aktet e nevojshme ne zbatim te ketij ligji.

Neni 30

Aktet ligjore e nenligjore qe jane ne kundershtim me keresat e ketij ligji, shfuqizohen.

Neni 31

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere, me perjashtim te neneve 9,10,11,12,13,14 dhe 15 te cilat hyjne ne fuqi me 1.1.1991.

PRESIDENTI I REPUBLIKES
RAMIZ ALIA